



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Received	Ditëzuar / Received	05.04	2	viti / year
Organ / Organi	D. Prit / D. No.	1897/2022		
	Shtesa / Annex			1/5
	Sasia / Quantity			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.200/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën e datës 02.03.2022 me numër A.Nr.200/2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit

Policia e Kosovës, në çështjen juridike „kontestim konkursi” dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.04.2022 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET si e bazuar ankesa** me numër A.nr.200/2022 e datës 02.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

**II. ANULOHET** Njoftimi me numër të referencës: 07/1-01SAP-R/001/2022 i datës 02.02.2022 i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, për verifikimin e së kaluarës të kandidatit të përzgjedhur nga procedura e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën: “Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit” në Policinë e Kosovës.

**III. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës që të bëjë përfundimin e procesit të rekrutimit për pozitën Drejtor i Prokurimit në Policinë e Kosovës dhe ti lëshoj Akt emërimin ankuesit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

**A r s y e t i m**

Ankuesi ka aplikuar në procedurën e rekrutimit të shpallura nga Policia e Kosovës, për lëvizje brenda kategorisë për pozitën: “Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit” në Policinë e Kosovës, me datë 24.11.2021 deri me datë 01.12.2021, sipas njoftimit të datës 09.11.2021. Sipas shkresave të lëndës në këtë procedurë rekrutimi kanë aplikuar pesë (5) kandidatë, nga pesë (5) kandidatë, prej tyre vetëm ankuesi e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak sipas njoftimit të datës 15.12.2021 me numër reference 07/1-01SAP-R/026/2022, i cili me datë 10.01.2022 është ftuar për intervistë me gojë dhe me datë 11.01.2022 përmes E-



mailit zyrtar është njoftuar se nga intervista me gojë ka arritur gjithsej 76.6 pikë të mjaftueshme për emërim në pozitën e shpallur sipas përshkrimit të lartshënuar..

Ankuesi me datë 02.02.2022 është njoftuar me Njoftimin me numër të referencës:07/1-01SAP-R/001/2022, e nxjerrë nga Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, lidhur me mos kalimin e fazës së verifikimit të së kaluarës, si kandidat i përzgjedhur nga procedura e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë, në pozitën: "Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit" në Policinë e Kosovës, duke përfunduar procedurën pa fitues.

I pa kënaqur me këtë njoftim ankuesi me datë 08.02.2022 ka parashtruar ankesë tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës, për rishqyrtimin e njoftimit me numër reference:07/1-01SAP-R/001/2022 të datës 02.02.2022, ndërsa Drejtoria e Personelit Burimeve me datë 15.02.2022 ka nxjerrë përgjigje drejtuar ankuesit, duke e udhëzuar që të drejtohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën përgjigje e ka pranuar me datë 02.03.2022.

Ankuesi me datës 02.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1114/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin e Njoftimit me numër reference:07/1-01SAP-R/001/2022 të datës 02.02.2022 të Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, dhe kundër përfundimit të procedurës së rekrutimit pa fitues për lëvizje brenda kategorisë së pozitës "Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit" në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.03.2022 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës, ndërsa me datë 15.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 1114/2022 e datës 02.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.200/2022; Njoftimi i datës 11.01.2022 në formë elektronike i Njesisë së Rekrutimit dhe Selektimit -Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës; Konkursi i datës 24.11.2021; Njoftimi i datës 15.12.2021 nr.referencës: 07/1-01SAP-R/001/2022; Njoftimi i datës 21.12.2021 nr.referencës: 07/1-01SAP-R/028/2022; E-maili i datës 11.01.2022; E-maili i datës 23.12.2021; Pasqyra e nxjerre nga programi elektronik SIBMNJ; Njoftim i datës 02.02.2022 nr.referencës:07/1-01SAP-R/001/2022; Certifikatë e datë 12.01.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vërtetim i datës 13.01.2022 i nxjerre nga Policia e Kosovës; Përgjigje e datës 15.02.2022; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2022, me shkresat e bashkëngjitura Vendimi i datës 24.12.2021 për emërimin e komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë; Vendim i datës 28.12.2021 për ndryshim të vendimit të komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë; Lista e aplikantëve e nxjerrë nga sistemi SIBMNJ dhe lista e aplikantëve të aprovuar dhe të refuzuar, E-mail i datës 22.12.2021; Ankesë e datës 08.02.2022; E-mail i datës 18.02.2022, për përgjigje në ankesën e datës 08.02.2022, Email i datë 16.02.2022 .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili kundërshton përfundimin e procedurës së rekrutimit pa fitues për lëvizje brenda kategorisë së pozitës "Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit" në Policinë e Kosovës, ngase ankuesi ishte përzgjedhur në këtë pozitë sipas njoftimit në formë elektronike të datës 11.01.2022 të Njesisë së Rekrutimit dhe Seleksionimit Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, pasi që me datë 11.01.2022 përmes E-mailit zyrtar është njoftuar se nga intervista me gojë ka arritur gjithsej 76.6 pikët e përgjithshme, Kolegji konstaton se pretendimet e ankuesit janë të bazuara lidhur me faktin se ankuesi është shpallur kandidat i suksesshëm nga procedura e rekrutimit me numër reference RN00007817, e shpallur me datë 24.11.2021 deri me datë 01.12.2021, sipas njoftimit të datës 09.11.2021, nga Policia e Kosovës, për lëvizje brenda kategorisë për



pozitën :”Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit” në Policinë e Kosovës, pasi që i njëjti ka kaluar të gjitha fazat e verifikimit paraprak në pajtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe verifikimin para emërimit të përcaktuar në nenin 29 dhe nenin 30 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe se konkursi për lëvizje brenda kategorisë është publikuar në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nenin 43 paragrafi 1 dhe përshtatshmërisht me nenin 9 të kësaj rregulloreje.

Njësia përgjegjëse e Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve, në pajtim me nenin 45 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se:”**2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ**”, bazuar në Njoftimin me numër reference:04/1-01SAP-R/026/2022 të datës 15.12.2021, duke përfshirë ankuesin si kandidat të vetëm i cili i ka plotësuar kushtet për vazhdimin e procedurës për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e lirë: ”Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit” në Policinë e Kosovës.

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00007817, ankuesi është shpallur kandidat fitues nga intervista me gojë nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, në Policinë e Kosovës, i cili ka arritur gjithsej 76.6 pikët e përgjithshme, bazuar në Njoftimin në formë elektronike të datës 11.01.2022 të Njesisë së Rekrutimit dhe Seleksionimit, Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, i cili vlerësim është bërë në bazë të dispozitës ligjore të nenit 38 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se :” **6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t’u emëruar në vendin e lirë,...**”.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës nga të dy palët, ka konstatuar se pretendimet e ankuesit për anulimin e procedurës së rekrutimit sipas njoftimit me numër reference: 07/1-01SAP-R/001/2022 të datës 02.02.2022 për lëvizje brenda kategorisë për vendin e lirë të punës ”Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit” në Policinë e Kosovës, janë të bazuara lidhur për faktin se, anulimi i procedurës është bërë në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se:” **1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:..... 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje**”, sepse në rastin konkret Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se ndaj ankuesit ka vendim për kryerjen e një vepre penale, pasi ndaj tij është bërë verifikimi i së kaluarës penale, i cili është kandidat fitues në procedurën e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën: “Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit” në Policinë e Kosovës.

Kolegji konstaton se nga provat e bashkëngjitura nga dy palët në procedurë, është bashkëngjitur “Certifikatë nga Evidenca e Personave Kundër të Cilëve është duke u zhvilluar Procedurë Penale dhe Personave të Dënuar...” e datës 12.01.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Glogovcë me Nr.204/2022 me të cilën është vërtetuar se ankuesi nuk është i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë penale, si dhe është bashkëngjitur vërtetimi i datës 13.01.2022 lidhur me të kaluarën kriminale të ankuesit me të cilin vërtetimi është vërtetuar se ankuesi nuk ka dosje në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës.

Gjithashtu Kolegji konstaton se ngase u tha më lartë ankuesi ka të siguruar të gjithë dokumentet e nevojshme lidhur me verifikimin paraprak që është në pajtim me nenin 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj Kolegji konstaton se sipas ligjit dhe akteve nën ligjore që rregullojnë këtë fushe ankuesi i plotëson kushtet për tu emëruar në pozitën të cilën e ka rekomanduar Komisioni rekrutues ashtu siç është përshkruar më lartë.

Kolegji sqaron edhe më tutje se ankuesi nuk ka asnjë pengesë për emërim edhe sa i përket dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Kolegji në këtë rast thekson edhe pikën 187 dhe 188 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetues Nr. KO203/19 në të cilën përcaktohet saktë se nëpunësit civil të punësuar në Policinë e



Kosovës nuk mund të trajtohen ndryshe nga Ligji për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, sepse ... “dhe si pasojë nuk është e nevojshme që të trajtohen në mënyrën e njëjtë sikurse zyrtarët policorë, zyrtarët e inspektoratit, zyrtarët doganorë dhe nëpunësit e AKI-së”.

Po ashtu Kolegji konstaton se Drejtoria e Personelit për fazën e verifikimit të kandidatëve respektivisht për të kaluarën për kandidatin fitues, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe se Njësia përgjegjëse në Policinë e Kosovës me rastin e anulimit të kandidatit fitues ka vepruar në kundërshtim me nenin 29 paragrafi 2 nën paragrafin 2.3 dhe nenin 30 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: **“2.Verifikimi përfundimtar përfshin:..... 2.3. verifikimi i vazhdimit të plotësisht të kushtit të tjera të parapara nga neni 8 i Ligjit”**, neni 30 paragrafin 1 **“1.Njësia Përgjegjëse, pas kryerjes të verifikimit, emëron kandidatin në pozitën e përzgjedhur nga ai. Akti i emërimit i drejtohet kandidatit dhe institucionit të përzgjedhur”**, për mos emërimin e ankuesit në pozitën **“Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit”** në Policinë e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pasi që Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Policinë e Kosovës, ka rekomanduar ankuesin si kandidat fitues për pozitën **“Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit”** në Policinë e Kosovës, Njësia përgjegjëse gjegjësisht Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit të Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, ka qenë dhe është e obliguar që të emëroj kandidatin fitues siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 49 paragrafi 2, që përcakton se: **“Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi.....”**, mbi këtë bazë në shërbimin civil ka të drejtë të emërohet kandidati fitues.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës obligohet që të aprovoj procedurën e rekrutimit si të rregullt duke u bazuar në Njoftimin e datës 11.01.2022 të Njesisë së Rekrutimit dhe Seleksionimit, Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, lidhur me rezultatin përfundimtar nga procedura e rekrutimit me numër reference RN00007817, për kandidatin fitues në këtë pozitë, i rekomanduar nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Policinë e Kosovës, sepse ankuesi i ka plotësuar kushtet për tu emëruar, pasi që është vërtetuar se nuk është i dënuar me vendim për ndonjë vepër penale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit, e Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, me rastin e njoftimit të kandidatit të suksesshëm në procedurën e rekrutimit me numër Referencë RN00007817 ka vepruar në pajtim me nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me rastin e nxjerrjes së Njoftimit të datës 11.01.2022 duke zbatuar afatet dhe përgjegjësit në pajtim me bazën juridike të përcaktuar në këtë rregullore, për procedurën e pranimit të zyrtareve publik dhe për lëvizje brenda kategorisë për pozitën: **“Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit”** në Policinë e Kosovës të përcaktuar në nenin 38 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A.NR.200/2022**

Zyle Millaku -GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit

*Vendimi i dërgohet:*

- Ankuesi
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.